



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 45/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit “Universum”, Nr. 3513/21H datë 01.11.2021 për akreditim të programeve të studimit:
 - Diplomaci. MA, 120 ECTS (ri akreditim)
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Kolegji “Universum” ka parashtruar kërkesë (Nr. 3513/21H datë 01.11.2021) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programit të studimit: Diplomaci, MA, 120 ECTS (ri akreditim),

Bazuar në pikën 1.2 të Nenit 10 të UA për Akreditim ku thuhet, “Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”, KShC në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2021 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga ky Kolegj.

1/2

- **Për programin Diplomaci, MA, 120 ECTS (ri akreditim)**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Judita Hajdari (PhD në Shkenca Politike) dhe Shpresa Kaçiku-Baljija (PhD në Qeverisje).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve”.*

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se titulli PhD i bartësve Judita Hajdari dhe Shpresa Kaçiku-Baljija nuk përkon me fushën e programit të studimit.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Diplomaci, MA, 120 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Pastaj, ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “Universum”
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Nazi
Kryetare e Këshillit Shkencor të Cilësisë

